



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 te Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e 14) me dt.27.11.2018 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:



Dokëz-izlazna  
Nr. 1-A/1  
Data  
Datum  
13.11.2018  
R E N D D I T E  
DOK. 10-OBILIĆ

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Adem Jashari” në Obiliq
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Obiliqit
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izlaçna

Nr. T- 165

Data  
Datum

30.10.2018

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

GJILANI-GJILAN

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.10.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Florije Jashari, Shaip Paloja, Linda Sadiku, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Hysni Mjeku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Naim Miftari, drejtor i DSHPE-së, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Fatmir Bërbatovci, drejtor i DKRS-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Ibush Mjekiqi, drejtor i DSHMS-së Ferid Hashani, drejtor i bujqësisë, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, Ganimete Aliu, përf. e OSBE-së, mediat, përf.e OVL-së, dhe qytetarët

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstataoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

### R E N D      D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i raportit 9 mujob finansiar i Kryetarit të Komunës
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së
5. Zgjedhja e Këshillave të fshatrave dhe Lagjeve Urbane sipas Rregullores nr.-I-48, të dt.30.04.2015
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

**1.Pika e parë e rendit të ditës –**

Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal.

**2.Pika e dytë e rendit të ditës –**

**Qëndresa Dubova** – Paraqet vërejtje në ekstrakin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar sepse një kërkesë që e kam bërë në mbledhjen e kaluar për Drejtorinë e Arsimit, këtu po figuron një emër tjetër Qëndresa Krasniqi. Këtë vërejtje e kam bërë edhe në mbledhjet e kaluara të KPF-së se mbiemri im nuk figuron në procesverbal dhe shpresoj të jetë vërejtja e fundit.

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e cekur më lartë. Linda Sadiku e lëshoi mbledhjen me arsyen.

**3.Pika e tretë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, propozimin e Kryetarit për emërimin e sheshit të qytetit e kemi trajtue edhe në mbledhjen e KPF-së, por në ndërkohë kanë ardhë edhe 2 kërkesa, kërkesa e veteranëve të luftës së UQK-së dhe kërkesa nga LVV-ja.

**Armend Rushiti** – Propozoj që emri i sheshit të qytetit të jetë “Sheshi i dëshmorëve”.

**Burim Gërguri** – Lexon 3 kërkesa lidhur me emërtimin e sheshit të qytetit dhe atë: kërkesën nga Kryetari i Komunës, me propozimin që sheshi i qytetit të emërohet “Adem Preniqi” kërkesën nga Shoqata e veteranëve e luftës së UQK-së me propozimin e dhënë “Sheshi i dëshmorëve” dhe kërkesën nga LVV-ja me propozimin e dhënë “Luftëtarët e lirisë”.

**Enver Gashi** – Sot kemi ardhë në Kuvend që të emërohet zyrtarisht emri i sheshit të parë në Obiliq “Adem Preniqi”. Arsyeva pse ky emër është se unë kam pasë fatin ta njohë në rini personin në fjalë si një ndër themeluesit e parë në demokraci të Lidhjes Demokratike. Bashkë me z.Adem Preniqi, kemi punuar në Arsim, kemi punuar në KEK, dhe ai gjatë luftës e ka dhënë kontributin e vet, që për këtë shumë mirë e din ana e Qyqavicës. Në periudhën e pasluftës, z.Adem e ka dhënë kontributin e vet si asambleistë dhe si kryesues i Kuvendit Komunal. Ne të gjithë asambleistët dhe ky pushtet komunal që sot është e kemi obligim moral që ta përkrahim këtë emër, por edhe mendimi i qytetarëve është për emërimin e sheshit të parë “Adem Preniqi”. Uroj të gjejmë gjuhë të përbashkët dhe ta votojmë unanimisht.

**Shaip Paloja** – Ne si grup nuk kemi propozim, i përshëndes 3 propozimet dhe sigurisht se do të deklarohemi gjatë votimit.

**Lulzim Sadiku** – Fillimisht urime për një shesh kaq madhështor në Komunën tonë dhe ne si Parti demokratike i vlerësojmë 3 opcionet për emërimin e sheshit. Mirëpo, për shkak të rrethanave dhe kohës mendojmë se njerëzit më meritor për të lënë emra janë familjet e dëshmorëve, veteranëve të luftës dhe Shoqatat e dalura nga lufta. Ne si grup do ta mbështesim opcionin e Shoqatave të dalura nga lufta.

**Armend Rushiti** – Mendoj se emri i një sheshi unifikon të gjithë dëshmorët të cilët kanë rënë në luftën e fundit në Kosovë dmth është një emër unifikues. Duke marrë parasysh se arkitektura e sheshit përmban edhe gdhendjen e emrave të tyre aty, si dhe në qendër të fontanës do të vendoset stema e UÇK-së, mendoj se këto, janë disa fakte të cilat më së miri e përfaqësojnë emërimin “Sheshi i dëshmorëve”.

**Aziz Bici** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, edhe në komunikatat tona nga LVV-ja, propozimin e Kryetarit të Komunës, për emërimin e këtij sheshi e kemi quajtur politik. Ne konsiderojmë se emri i sheshit të qytetit duhet të jetë i atillë që përfaqëson unitet të qytetarëve, që nënkupton emrin e dikujt të dëshmuar kombëtarisht pa ngjyrime partiale dhe elektorale. Emri i të propozuarit nga Kryetari nuk është i tillë dhe si rrjedhojë nuk mund ta aprovojmë. Me kërkesën e drejtuar për shqyrtim përmes 3 reshtave thuhet se propozimi është bërë duke u bazuar në kërkesat e shumta të qytetarëve. Ne si LVV, kërkojmë që të jeni më të saktë dhe të na tregoni se kur është zhvilluar ndonjë debat publik për këtë çështje, apo kur është hapur ndonjë konkurs ku qytetarët kanë bërë propozimet e tyre. Manipulimet e tillë në emër të qytetarëve për neve janë të papranueshme. Ne konsiderojmë se emërtimi i këtij sheshi duhet t'ju dëshmoj brezave të ardhshëm historinë dhe sakrificën e popullit për liri dhe pavarësi. Duke ditur se Obiliqi, ka dëshmorë me emrat e të cilëve krenohemi të gjithë ne dhe secili emër i secilit dëshmor të propozuar qoftë ai i Komunës së Obiliqit, apo Kosovës, do të përbënte titull madhështor për këtë shesh. Mirëpo, ne konsiderojmë se duke llogaritur dhe vlerësuar kontributin e të gjallëve, apo të atyre që nuk patën fatin të vdisnin në vijën e frontit, duke e pasur të vështirë të zgjidhësh mes emrave të këtyre dëshmorëve, ndaj të cilëve duhet të përkulemi në çdo kohë. Poashtu, duke vlerësuar kontributin madhor të secilit luftëtarë të lirisë të luftës së fundit, por edhe të luftërave të mëhershme, duke vlerësuar kontributin e secilit qytetarë e veprimtarë që ndihmuani luftën tonë çlirimtare, propozojmë që emri i sheshit të jetë “Luftëtarët e lirisë”. Poashtu, në këtë shesh propozojmë që të vendoset një pllakë ku do të gdhendeshin emrat e dëshmorëve dhe secilit ushtar të vërtetë të UÇK-së, nga Komuna jonë. Ne konsiderojmë se propozimi i Kryetarit kuptohet krye në vete, është i ngutshëm dhe anashkalues ndaj dëshmnorëve dhe heronjëve, sacrificës së tyre dhe familjeve të tyre për lirinë që sot po e gjëzojmë. Prandaj, ju lutemi që të paktën njëherë ti thirrni arsyes dhe ta mbështetni propozimin tonë që respekton çdo dëshmorë, çdo hero, çdo familjar të tyre dhe çdo qytetarë të Obiliqit dhe të Kosovës.

**Nazmi Gashi** – Më duket se është pak një artmosferë që nuk e kemi merituar kështu dhe nuk kemi nevojë ne të lodhemi shumë për gjëra që historikisht dihen. Unë kam mendue se ne duhet të gjëzohemi për një investim mbi 1 milion €, duhet të gjëzohemi se na është dhënë mundësia me ndërrue gjendjen e qytetit. Mendoj se çfarëdo emri i shqiptarëve që emërohet në këtë rast është meritor, përkundrazi edhe më meritor janë 3 rastet e cekura pak më heret. Unë e kam borxh të them meqë kanë rrjedhë fjalë të ndryshme se kam presion, që pikërisht po them se s'kam kurrfarë presioni prej z.Ajet Berisha, se qysh me vendosë a me votu, apo mos me votu, a me përkrahë apo mos me përkrahë. Edhe emrat që i kemi vendosë deri më tash

nuk jemi duke i kontrollue aq shumë sepse dëshmorët kanë vdekë me të gjitha gjymtyrët, ndërsa busti i tij është pa dorë, pa këmbë etj. Mendoj se nuk është me rëndësi emri që e vendosim, por sa po i ruajmë, sa po i përkrahim ne, sa po i mbikqyrim e po ua kushtojmë tërë jetën atyre, që e kanë meritue. Unë në LB, kam shkue në grup të përbashkët dhe e çmoj si parti politike që e ka dhënë kontributin e vet gjatë tërë kohës, por s'do të thotë se unë kam mendim partiak ashtu qysh e ka LB-ja, sepse nuk jam në program partiak të LB-së. Megjithatë, kur është me vend, e qëlluar dhe në interes të qytetarit edhe LB-në, PDK-në, LDK-në, dhe AAK-në, unë i kam përkrahë gjithë kohën. Misioni im deri në fund të këtij mandati dhe në mandatet tjera është çështja pozitive, çështja në interes të qytetarit, çështja e ekzistencës në radhë të parë me gjetë mjete me zhvillue ekonominë, jetën, qytetin sepse vetëm kështu shkojmë përparrë.

**Slavisa Spasic** – Unë i dëgjoja 3 propozimet dhe që të 3 propozimet janë të mira, por unë jam për propozimin e Kryetarit të Komunës

**Burim Gërguri** – Sipas procedurës kërkesa e parë është që ka ardhë prej Kryetarit të Komunës me propozimin që sheshi i qytetit të emërtohet “Adem Preniqi” dhe këtë po e hudhi në votim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 13 vota “Për” 4 vota “Kundër” dhe 3 vota “Abstenim” morën këtë:

## V E N D I M

**Emërohet Sheshi i ri në qendër të qytetit në rr.”Hasan Prishtina” me emrin e veprimitarit “Adem Preniqi” .**

### **4.Pika e katërt e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Në mbledhjen e KPF-së, është trajtue Raporti 9 mënyrë financiar i Kryetarit të Komunës dhe tash fjalën ia japë Kryetarit, të na njoftoj më gjërësisht për raportin në fjalë.

**Kryetari** – Ju, e keni marrë raportin më heret dhe me siguri e keni trajtue, i keni edhe sugjerimet nëse keni me plotësue. Nga 2,846,643 €, kanë mbetë edhe 26,999.29 të lira, që në zotim i keni këto, mallra dhe shërbime janë 355,748.06 dhe mbetja është 97,393.32, shpenzime komunale kanë qenë 37,052, mbetja është 16,919 €. Subvencione dhe transfere nga 74,366 €, mbetje janë edhe 41,013, shpenzime kapitale nga 1,553.131 €, mbetje janë 327,762 €. Totali i buxhetit për kategoritë e përmendura është 4,866,960.97 janë edhe 510,088 të lira. Donacionet i keni parë, kategoria 10, 21, 22, totali i buxhetit është 6 milion e 61.34, shpenzimet kategoria 10, 3,457,980.59 €, shpenzimi kategoria 21, 136, 348.46, shpenzimi i kategorisë 22, 72,599. Në total shpenzimi është 3,722,724 €, zotimi 1,827,552.11, në total të lira i përmendëm edhe njëherë janë 511,073.69. Plani i të hyrave vetanake 2018, ka qenë 876,728 €, realizimi është 820,918 €, që i bjen dikund 93.63 %.

**Burim Gërguri** – Unë e falenderoj Kryetarin bashkë me Ekzekutivin për punën e jashtëzakonshme që është duke e bërë për qytetin tonë pa dallim për të gjithë qytetarët e Obiliqit. Unë edhe në mbledhjen e KPF-së, e falenderova drejtoreshën e finanacave për inkasimin në raportin 9 mënyrë në raport me të hyrat e planifikuara dhe mbledhjen, që ishte mbi masën 93 % dhe uroj që edhe shpenzimi të jetë kështu në raportin përfundimtar.

### **5.Pika e pestë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën e DKRS-së, për dhënien në shfrytëzim të Shtëpisë së kulturës, në Milloshevë, dhe më gjerësisht për këtë do të na informon drejtori.

**Fatmir Bërbatovci** – Objekti i Shtëpisë së kulturës në Milloshevë, është një objekt shumë i përshtatshëm për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, arësimore dhe për organizimin e kurseve të ndryshme. Prandaj, ne si Drejtori kemi paraparë që konform ligjet për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim i kemi propozue Kryetarit, pastaj Kryetari Kuvendit që të jepet për 5 vite në shfrytëzim. Arsyja është se ky objekt edhe më heret është shfrytëzuar nga një OJQ dhe komuniteti ka qenë i kënaqur me shërbimet e ofruara nga ajo OJQ. Kriteret janë të përcaktuara me ligj dhe mendojmë se do ta merrë ndonjë OJQ, e cila do të ofron kurse të ndryshme dhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe arësimore.

**Xhezide Dragusha** – Pyet se a ka mundësi me ditë se cila organizatë po e merrë në shfrytëzim.

**Burim Gërguri** – Përgjegjet se nuk ka organizatë dhe kjo është shpallje publike. Fillimi si takohet Komisioni për dhënjen e pronave, bëhet oferta publike dhe kushdo që oferton ai Komision ka me sjellë çështjen prapë në Kuvendin komunal. Pastaj, me 3 oferta në bazë të vlerësimit varësisht prej propozimit prej 1-5 vjet, bëhet dhënja e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtë.

**Shaip Paloja** – Nëse, marrim vendim duhet të përcaktohet saktë se çka nuk mund të punohet në atë pjesë sepse aty është edhe një pronë e paluajtshme. Atij që i jepet në shfrytëzim nëse, ne nuk e përcaktojmë në vendim ai mund të ndërtoj diçka, ose të ia ndryshoj destinimin. Mendoj se vendimi duhet të saktësohet në atë pjesë, të përcaktohet se për çka mund të jepet në shfrytëzim dhe mos të keqpërdoret. Ne kërkesën e kuptuam, por gjatë 5 viteve të ardhshme nuk e dijmë se për çka dhe si ai do ta përdorë, prandaj është mirë të përcaktohet saktë në vendim nëse e nxjerrim.

**Aziz Bici** – Unë e kam vetëm një pyetje, a nuk ka mundësi Drejtoria e kulturës me menaxhue Shtëpinë e kulturës, a kishte me qenë më në interes të komunitetit me menaxhue vetë Drejtoria.

**Kryetari** – Sa i përket çështjes së menaxhimit nga Komuna, me dëshirë kishte me bë Komuna, por në aspektin e personelit është i mangët. Ne kujtdo që ia japim në shfrytëzim mundemi me ia dhënë me kushte, me paralajmërim ashtu qysh është e përcaktuar me ligj nëse, kurdoherë që i vyen Komunës mundemi me ia marrë. Sa i përket afatit të shfrytëzimit të objektit, ju mund ta jepni prej 1-5 vjet, varësisht sa ju e konsideroni të arsyeshme.

**Nazmi Gashi** – Mendoj se është mirë nëse, mundemi me gjetë një mbikqyrje të mirë të atij që e shfrytëzon, por që ka dobi edhe Komuna për një afat derisa Komuna ti krijon mundësitë me marrë në menaxhim dhe kontrollë të vetë. Pra, është mirë të mos mbetet i boshatisur, por me ia dhënë dikujt me kushte të volitshme, me kushte që ia shohim hajrin.

**Fatmir Bërbatovci** – Sqaron se vetëm objekti jepet në shfrytëzim, e jo toka dhe atë prej 1-5 vjet. Ne si Drejtori konsiderojmë se objekti është në gjendje të mirë fizike duke ju falenderuar një organizate e cila sigurisht sipas procedurave e ka shfrytëzue deri në gusht të këtij viti dhe asaj kontrata i ka përfundue. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 18 vota “Për” dhe 1 votë “Kundër” morën këtë:

## V E N D I M

**Paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të Shtëpisë së Kulturës e cila gjendet në Milloshevë**

### 6. Pika e gjashtë e rendit të ditës -

**Burim Gërguri** – Nga mbledhja e KPF-së, ka dalë rekomandimi për formimin e Komisioneve komunale për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve Urbane sipas Rregullores nr.I-48, të dt.30.04.2015,

- Shqyrtimi i propozimeve përritjen e numrit të Këshillave të fshatrave dhe Lagjeve urbane
- Shqyrtimi i propozimit përkompenzim të anëtarëve të Komisioneve.

Ju njoftoj se në bazë të Rregullores, Këshillave të fshatrave dhe Lagjeve Urbane, mandati ju ka skadue dhe ne obligohemi të formojmë Komisionin dhe të zgjedhen. Bazuar në telashet që i kemi pasë rreth disa vendbanimeve, lidhur me zbatimin e Rregullores nr.I-48, të dt.30.04.2015, mendoj se është mirë të marrim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores, që të rritet numri i Këshillave të fshatrave. Propozoj që kjo Rregullore, të dalë në debat publik me procedura të shpejta, në mënyrë që në mbledhjen e radhës të aprovohet me numrat e ri të Këshillave të fshatrave.

**Enver Gashi** – Ju lus, njerëzit të cilët i propozoni në Komision, të janë njerëz që punojnë sepse nuk është një punë aq e lehtë. Neve, na vjen të formohen edhe 6 Këshilla, që nuk është një numër aq i madh dhe më mirë është që çdo fshat me pasë Këshillin e vet, mirëpo nëse punohet sipas Rregullores punë ka mjaft.

**Shaip Paloja** – Mua, sa më kujtohet kur është nxjerrë vendimi për formimin e Këshillave të fshatrave, në vitin 2008, kam unë qenë në Asamble në atë kohë dhe parashihet që Kryetari i Këshillit të fshatit të ketë një meditje dikund rreth 30 €.

**Burim Gërguri** – Sqaron se në Rregulloren e vitit 2015, është e përcaktuar që Kryetari i Këshillit të fshatit të kompenzohet për punën e vet. Këshillat e fshatrave, kanë edhe obligime ligjore, pasi që

formohen me vendim të Kuvendit, bartin kompetenca, që ne mundemi me ia adresu e poashtu edhe Ekzekutivi, Kryetari në këtë rast mundet me ia adresu kërkesat që ata do ti trajtojnë. Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën këtë:

## V E N D I M

**Për dhënien në diskutim publik të Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Obiliqit.**

**7. Pika e shtatë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Në rekomandimet e KPF-së, kërkesat tjera të cilat u shqyrtuan dhe u dërguan në Drejtoritë përkatëse dhe te Kryetari i Komunës, ka qenë kërkesa nga fshati Grabofc i Epërm dhe Shipitullë, e dërguar te Kryetari i Komunës për investime kapitale. Kërkesën nga OJQ “Zëri i romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve” ia kemi dërgue DKA-së, për shqyrtim. Poashtu, kërkesën nga “Bas Trade” ia kemi dërguar DPUKP-së, për shqyrtim dhe për një sqarim më detal rrith kësaj kërkese, fjalën ia japë drejtorit.

**Arben Berisha** – Ne e kemi shqyrtue këtë kërkese dhe lejen në atë kohë e ka lëshue me vendim Bordi i drejtorëve, por tash me ligjin e ri Bordi nuk është më organ vendimmarrës, por rekomandues ndaj Kryetarit. Kompania në fjalë është pajisë me leje urbanistike, i ka paguar 10,000 €, pagesë por ka ngeçë në pagesat e tyre, për arsyet e vështirësive financiare. Sipas ligjit për lejet nëse, nuk përfundohet brenda 1 viti, atëherë pala nuk mund të pajiset me leje. Nëse, ju merrni vendim që DPUKP ti nisë procedurat për dhënien e lejes, ai e ka edhe një pagesë dhe unë mund të ia lëshoj lejen, përndryshme me keqardhje Drejtoria nuk mund të merret me rastin. Mirëpo, një vendim i juaji kishte me krye punë për shkak të kompanisë sepse s'mund të ushtroj aktivitetin për shkak se s'ka leje.

**Nazmi Gashi** – Nëse, i takon me ia dhënë lejen sipas ligjit, Drejtoria le t'ja jepë, por nëse nuk i takon atëherë përgjegje duhet me i kthye. Nëse, Drejtoria e shehë se janë pjekë kushtet, e lejon ligji që të pajiset ai me leje, atëherë le të pajiset dhe pse po na sjellni në këtë situatë sepse çka dijmë ne se në çfarë rrithana dhe kushte është ai, jo vetëm për këtë rast, por për të gjitha rastet. Drejtoria e ka ligjin për aplikim, le të vazhdoj, ne jemi këtu, për me ndihmë dhe çdo vendim i drejtë i Drejtorisë e ka përkrahjen tonë.

**Shaip Paloja** – Pajtohem me diskutimin e z.Nazmi Gashi, dhe mendoj se ligji është për të gjithë i barabartë dhe duhet ti ketë pasojat, kush nuk e ka zbatue ligjin kompania apo Drejtoria, që ka qenë e obliguar me zbatue. Mendoj se kjo nuk është punë e Kuvendit komunal.

**Aziz Bici** – Edhe për mua është e paqartë dhe kishte me qenë mirë nëse, mundesh me na qartësue diçka më tepër.

**Arben Berisha** – Sqaron se kanë kaluar 8 vite, nga mosmarrja e lejes dhe ai vetëm i ka filluar procedurat që sipas shkresës së tij thuhet s'ka pasë mjete financiare të mjaftueshme për me i krye pagesat dhe s'ka mund të pajiset me leje. Unë si drejtor nuk mund të ia lëshoj lejen sepse kanë kaluar afatet, por nëse ju merrni vendim për vazhdimin e procedurave, unë i vazhdoj procedurat dhe ia japë lejen, përndryshe ai mbetet deri në legalizim. Vendimi juaj nuk është i kundërligjshëm, por ju jeni ata që vendosni.

**Aziz Bici** – Unë kërkoj që ju ta zbatoni ligjin sepse ne si anëtarë të Kuvendit këtu, mendoj se s'mund ta zëvendësojmë ligjin.

**Kryetari** – Kjo që po insiston drejtori është se objekti është i ndërtuar dhe ne këtë e dijmë të gjithë në hyrje të Obiliqit, por siç e potencoi drejtori atëherë vendimi është marrë nga Bordi i drejtorëve dhe nuk e di se në atë kohë, a ka qenë i ligjshëm. Mirëpo, ai ende nuk është pajisë me leje për arsyet që u përmenden, por nëse ju vlerësoni se ai duhet me punue dhe votoni mirë e nëse, jo propozoj të mbetet në kohën e legalizimit, ose nëse ka dëshmi shtesë se ka mundësi ligjore, atëherë në seancën e radhës me sjellë prapë në shqyrtim.

**Burim Gërguri** – Propozoj që kjo çështje të mbetet për shqyrtim në mbledhjen e radhës në mënyrë që ne të pajisemi me material shtesë dhe ta shqyrtojmë në KPF, pastaj në Kuvend.

**Hysni Mjeku** – Meqë, shumica e anëtarëve nuk janë të informuar, por për hir të informimit më objektiv edhe në mbledhjen e KPF-së, është kërkuar që në këtë seancë të kemi shenime të sakta dhe pse nuk ka

dhënë leja x personit psh qe 10 vjet. Edhe unë propozoj që Drejtoria përkatëse, ta analizoj infrastrukturën ligjore, të na sjellë detajet se a ka mundësi me iu dhënë leja, apo nuk ka mundësi. Unë nuk e di se për kend bëhet fjalë dhe është irelevante individi, por relevante është mbështetja ligjore sepse nëse ka mbështetje ligjore pse mos me ia dhënë lejen dhe nëse, s'ka mbështetje ligjore pse me ia dhënë. Unë nuk e di ai qysh ka mund ti vazhdoj punimet pa një leje të tillë.

**Arben Berisha** – Sqaron se pala ka fillue procedurat, që të pajiset me leje ndërtimore me vendim të Bordit nr.01-243/10, të dt.21.09.2010, dmth është pajisë me leje urbanistike me 28.09.2010, pasi që i ka plotësuar kushtet në bazë të ligjit. Mirëpo, pala ka vazhduar me procedurat në kohën kur është pajisë me leje urbanistike, ekziston pagesa prej 10,000 €, dhe defekti është se pala ka ngecë në pagesë dhe s'ka mund të pajiset me vendim për leje të përdorimit.

**Nazmi Gashi** – Unë jam njohës i mirë i këtyre rrëthanave dhe drejtor na jepni një muaj afat që të ndihmojmë dhe ta zgjidhim këtë çështje.

**Arbnore Nasufi** – Në këtë rast po ia bëjë një pyetje inspektoriatit, pasi që po thoni se s'ka leje qe 10 vite pse nuk është bërë rrënim i saj. Dua ta di arsyen, pse deri tash nuk është bërë rrënim i kur po bëhet i shumë objekteve tjera më të vogla.

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën tjetër nga DPUKP, për rrënimin e objektit të vjetër të Komunës.

**Kryetari** – Siç e dijmë të gjithë tanë më sheshi ka filluar të ndërtohet, por sheshi do të ketë shtrirje edhe në pjesën ku aktualisht është objekti i vjetër i Komunës, pastaj edhe objektit që kanë qenë pjesë të aneksit të Shtëpisë së kulturës. Poashtu, kjo pjesa që ne i themi objekti i bardhë, pjesa e rrënojës te policia, por meqë jemi në fazën e punimeve dhe operatori ekonomik është duke i zhvilluar punimet, për neve kishte me qenë mirë që ai të fillon edhe me pastrimin e zonës ku do të ndërtohet sheshi. Në këtë rast bëhet fjalë për objektin e vjetër të Komunës.

**Hysni Mjeku** – Unë e kam një kërkesë që mundësish të na lajmëroni datën e saktë se kur do të rrënohet ai objekt sepse unë kam punuar aty, në gjendjen civile ku ka shumë dokumente me vlerë të madhe, që të tërhiqen dhe të deponohen në arkivin komunal. Aty, kanë mbetë edhe disa dokumente personale që për shkak të urgjencës është mirë me na njoftue, në mënyrë që ne një ose dy ditë përparrë ti tërheqim dokumentet personale, ndërsa ato zyrtare mbeten në arkivin komunal.

**Kryetari** – Ne jemi duke e bërë edhe inventarizimin, do të thotë krejtë materiali i mbetur deri më tanë pothuajse mbi 80 %, të të gjithave që kanë qenë në Komunë janë heqë nga aty dhe një pjesë janë shfrytëzue për shkolla, shëndetësi, kushdo që ka pasë nevojë. Ato normalisht me Komisione, sipas ligjit janë regjistruar në zonën ku janë shkue, pjesa tjetër që është për likuidim dhe pjesa tjetër e materialit që do të shpallet në ankand. Ne mendojmë se paraprakisht duhet të nxjerret vendimi për rrënim sepse deri në seancën e radhës besoj se këta kanë mundësi me pastrue terrenin, por patjetër të gjitha dokumentet që janë aty bartën, çdo material duhet të evidentohet, pastaj do të bëhet rrënim i saj.

**Aziz Bici** – Unë jam duke e parë se aty ka filluar rrëmihja dhe janë në rrezik drunjët gjatë prishjes së objektit. Pyetja ime është se a do të prishen drunjjtë, apo duhet të ruhen sepse mendoj se ata drunjë ia vlen me pasë kujdes dhe të ruhen.

**Kryetari** – Përgjegjet se ne e kemi diskutue edhe kur është bërë shpalosja e projektit dhe në Kuvend. Ne do të mundohemi të gjithë drunjët që janë sidomos te amfiteatri që tanë më i kanë filluar punimet atje, të gjithë drunjët e shëndoshë të ruhen sepse janë shumëvjeçar dhe vërtetë janë të mirë. Ne do të bëjmë plotësimë vetëm andej ku drunjët janë shumë të vjetër, disa që janë para Komunës, që kanë filluar të thahan do të zëvendësohen. Ndërsa, pjesa tjetër te pjesa e amfiteatrit, postës, pjesa e sheshit gjithëandej duhet të jetë e paprekur dhe kemi kërkuar edhe te projekti që të inkorporohen në shesh dhe të mbisin.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën këtë:

#### V E N D I M

**Që të rrënohet objekti i vjetër i Komunës, pasi që ka përfunduar procedura e tenderimit për ndërtimin e Sheshit në qendër të qytetit në rr.”Hasan Prishtina”.**

**Fatmir Bekteshi** – Unë e kam një kërkesë prej disa fshatarëve të Breznicës, gjegjësisht prej lagjes Haxhovite, është një pllakë përkujtimore e familjes Hoxhë Breznica, dhe ata e kanë bërë një kërkesë shumë të thjeshtë, vetëm me bë zyrtarizimin e saj dhe me kalue në monumente historike. Këtë e inicojmë ne, pastaj shkon në Ministrinë përkatëse.

**Burim Gërguri** – Kjo kërkesë është trajtuar edhe në KPF dhe DKRS-ja, na ka rekomandue që të nxjerrim vendim që këto asete kulturore dhe historike, të futen në listën e trashëgimisë historike të Komunës tonë.

**Aziz Bici** – Pyet se a ka mundësi të jepet diçka prej Drejtorisë së kulturës, ndonjë informacion shtesë për këtë çështje.

**Fatmir Bërbatovci** – Sa i përket Drejtorisë, ne veç e presim këtë vendim, përndryshe ne kemi fillue me ekipin e inxhinjerëve me bë projektin për vitin e ardhshëm, që në janar, shkurt fillon realizimi i projektit të monumentit.

**Fatmir Bekteshi** – Pllaka ekziston aty, ata nuk kanë ndonjë kërkesë të veçantë përvèç kësaj të legalizimit dhe ju lus që këtë çështje me inicue.

**Lulzim Sadiku** – Mua, vërtetë mu kujtua se ky rast ka qenë edhe në mandatin e mëhershëm të z.Krasniqi, që në fakt atëherë e kemi formue një Komision sepse aty kanë pasë problem 2 ose 3 familje, dhe ne këtë s'kemi mund me legalizue. Kërkoi prej Kryetarit që vërtetë, me shikue gjendjen reale ashtu qysh është dhe ne jemi pro legalizimit, por njëkohësisht me ditë mos me ndodhë ndonjë problem në mes të fshatarëve në atë pjesë. Unë konkretisht e di se ka qenë një problem, por ka qenë mbi 5 ose 6 vjet, që kanë ardhë 2 kërkesa brenda Kuvendit komunal dhe njëkohësisht ne jemi detyrue që me prolongue deri tash.

**Kryetari** – Mendoj se kishte me qenë mirë ju me votue, e formojmë një Komision i cili do ta bëjë një raport nga Kuvendi dhe Ekzekutivi nëse, është e domosdoshme, për me sjellë një raport përmblledhjen e radhës. Sa i përket çështjes së vendit, e tha edhe Fatmiri, është e vërtetë se unë i kam kontaktue pjesën e atyre banorëve dhe ata janë të interesuar si vepër, që ka ndodhë me mbetë në trashëgiminë kulturore, me mbetë e regjistruar siç i kemi edhe objektet tjera kulturore.

**Enver Gashi** – Këtu, u përmendë problemi i familjes dhe aty janë familjarë të ngushtë që një pjesë kanë qenë kundër kësaj çështjeje. Prandaj, është mirë që Komisioni kur të merret me këtë çështje dhe me z.Fatmir, si inicues i këtij projekti që familjarët të janë dakord të gjithë, të mos bëjmë ndasi në mes të familjes sepse nuk na takon se ne jemi përmblledhja e bashkue, e jo me bë ndasi.

**Kryetari** – Sqaron se nuk po kërkohet me u bë ndryshim, zhvendosje apo heqjen e pllakës, por këta janë duke kërkuar mbrojtje institucionale të atij monumenti historik.

**Fatmir Bekteshi** - Është e vërtetë se ata kanë pasë një mospajtim rrëth emrit, kanë dashë të quhet Hoxhë Breznica, ndërsa sipas kërkesës tjetër Hoxhë Idriz Breznica, por tash ata janë afue me bisedime dhe nëse, nuk gaboj kjo punë ka marrë fund.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën këtë:

#### V E N D I M

**Aprovohet që asetet kulturo-historike siç janë: Pllaka përkujtimore, 2 varre (Adem Krasniqi dhe Avdullah Krasniqi-babë e bir) dhe një bunar të cilat ndodhen në fshatin Breznicë (lagjja e Hoxhovitëve) të janë pjesë e Listës së Trashëgimisë Historike dhe Shpirtërore të Komunës së Obiliqit.**

#### **8.Pika e tetë e rendit të ditës -**

**Fatmir Bekteshi** – E kam një kërkesë për DSHPE-në, fshati Breznicë që një muaj nuk ka rrymë dhe çdo ditë ka reduktime prej orës 10-19. Këtu, problemi është se nuk po i shohim punëtorët që janë duke punue dikund, as në Breznicë, as në Stanovc. Kërkesa e dytë është te shkolla në Breznicë, ka qenë një pasyrë në komunikacion, te lagjja që shkon nga Koskovikët, por dikush e ka thyë dhe është mirë me vendosë prapë atë pasqyrë përmblledhja e komunikacionit.

**Dragan Dancetovic** – Në Baimoc, janë ndërmarrë masat e sigurisë, janë rritur patrollat e policisë dhe në këto momente vjedhjet janë ndalur, që sjellin siguri te banorët e fshatit. Unë e kam një pyetje lidhur me

informatën se janë dhënë subvencionet në bujqësi dhe më intereson se nga cilat fonde janë këto subvencione, cilat kritere kanë qenë dhe kush ka fituar.

**Ferid Hashani** – Përgjegjet se subvencionet janë ndarë një pjesë prej vijës së subvencioneve dhe një pjesë prej bashkëfinancimit psh serat janë te vija e bashkëfinancimit, fara e grurit është te subvencionet për bujqësi direkt dhe këto të gjitha i kemi shpërndarë.

**Labinot Mirena** – Kam një kërkesë prej familjes Ibrahimi nga Plemetini dhe ata kanë telashe me rrjetet kabllorike sepse deri afér po shkojnë, por jo deri në vendin e duhur. Unë e kam kërkesën prej 20 kryefamiljarëve, të cilët më janë adresue mua dhe mendoj se është mirë që DSHPE-ja, kur ua jepë lejen për shfrytëzim me marrë parasysh edhe kërkesën e tyre, sepse ka mbetë ajo pjesë si pjesë e harruar e territorit.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:5'**

Bashk.prof.për punë të KK



Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal



Burim Gerguri

